

**Coinvest SH.P.K.**  
**TIRANË - SHQIPËRI**

**Statuti**

Më, 21 qershor 2023



## KAPITULLI I: Emri, Forma Ligjore, Selia e Regjistruar, Kohëzgjatja

### Neni 1. | Emri i Shoqërisë

- 1.1 Shoqëria ka emrin **Coinvest** (“**Shoqëria**”). Në të gjithë dokumentet, faturat dhe publikimet e Shoqërisë, emri i saj do të paraprihet apo do të ndiqet nga fjalët “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” ose “Sh.p.k.”

### Neni 2. | Forma Ligjore e Shoqërisë

- 2.1. **Coinvest** është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar e organizuar në përputhje me ligjin shqiptar dhe me dispozitat e këtij Statuti (“**Statuti**”) dhe çdo ndryshim të tyre.

### Neni 3. | Selia e regjistruar e Shoqërisë

- 3.1. Selia e regjistruar e Shoqërisë është në adresën: Rruga “Jordan Misja,” kompleksi “Panorama”, kati 1, njësitë nr.10-13, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria ka të drejtë të transferojë selinë e saj në një adresë tjetër në Shqipëri.

### Neni 4. | Kohëzgjatja e Shoqërisë

- 4.1. Shoqëria krijohet për një kohë dhe afat të pakufizuar.

## KAPITULLI II: Objekti i aktivitetit të Shoqërisë

### Neni 5. | Objekti i aktivitetit të Shoqërisë

- 5.1 Objekti i aktivitetit të Shoqërisë është si vijon:
  - 5.1.1 Shoqëria do të kryejë çdo dhe të gjithë veprimtaritë financiare apo tregtare si institucion financiar jobankë dhe çdo veprimtari financimi për të gjithë format e kredidhënies, përfshirë por pa u kufizuar, në:
    - 5.1.1.1 dhënien e huave/kredi biznesi;
    - 5.1.1.2 qiranë financiare dhe veprimet dhe transaksionet, financimin apo veprime të tjera financiare në lidhje me të;
    - 5.1.1.3 faktoring dhe veprimet dhe transaksionet, financimin apo veprime të tjera financiare në lidhje me të;
    - 5.1.1.4 ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve;
    - 5.1.1.5 këmbimin valutor;
    - 5.1.1.6 ofrim i ndonjë lloji tjetër shërbimi financiar;
    - 5.1.1.7 shërbime këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e mësipërme.
  - 5.1.2 Kryerjen e çfarëdo veprimtarish dhe operacionesh të tjera, që nuk ndalohen nga legjislacioni shqiptar dhe për të cilat Shoqëria do të licensohet si institucion financiar jobanke, në përputhje me legjislacionin bankar dhe tregtar në Shqipëri.

- 5.1.3 Veprimtari dhe operacione të cilat janë të lidhura drejtpërdrejtë ose tërthorazi me qëllimet dhe subjektin e veprimtarisë së tij apo kanë gjasa të promovojnë arritjen e të tilla qëllimeve dhe subjektsh të veprimtarisë.
- 5.2 Burimet e Shoqërisë të nevojshme për zbatimin e veprimtarive të mësipërme janë fondet e veta, grantet apo donacionet e marra nga burime të lejuara ligjërisht, hua të ofruara nga të gjitha burimet e lejuara ligjërisht, si dhe të ardhura nga veprimtaritë e veta të kredidhënies apo veprimtaria e saj . Nëse nga ligjet e Republikës së Shqipërisë kërkohet një licensë, leje, certifikatë, apo ndonjë tjetër miratim për të kryer ndonjë prej veprimtarive të radhitura në këtë nen, Shoqëria angazhohet në veprimtari të tilla vetëm pasi të jetë lëshuar një licensë, leje, certifikatë apo miratim tjetër i tillë për Shoqërinë.
- 5.3 Në përputhje me legjislacionin shqiptar për përmbushjen e objektit të lartpërmendur, Shoqëria mund:
- (i) të marrë licencat dhe autorizimet përkatëse dhe të kryejë çdo transaksion në lidhje me dhënien e mikro-kredive, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar, qira, apo hipotekore, të cilat mund të konsiderohen të dobishme apo të nevojshme për përmbushjen e objektit të Shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara me sipër;
  - (ii) të blejë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, interesa në shoqëri të tjera, të cilat kanë një objekt (fushë veprimtarie) të ngjashme me Shoqërinë, në Shqipëri ose jashtë saj;
  - (iii) të kryejë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm për përmbushjen e objektit të Shoqërisë.
- 5.4 Shoqëria do të kryejë çdo aktivitet që përfshihet në objektin e saj të aktivitetit dhe/ose që lidhet me objektin e saj.
- 5.5 Shoqëria do të respektojë të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse në Republikën e Shqipërisë dhe standardet më të mira etike.
- 5.6 Shoqëria është pronare e të ardhurave të marra si rezultat i veprimtarive të saj tregtare dhe financiare, si dhe ndonjë prone tjetër të përfutur në përputhje me ligjin shqiptar. Prona e Shoqërisë përbehet nga asetet fikse dhe në qarkullim të saj.

## **Neni 6. | Ndryshimi**

- 6.1. Ortaku i Vetëm ka të drejtë të ndryshojë objektin e aktivitetit të Shoqërisë në çdo kohë siç parashikohet në këtë Statut.



## **KAPITULLI III: Kapitali i Regjistruar**

### **Neni 7. | Kapitali i regjistruar i Shoqërisë**

- 7.1. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 100.000.000,00 (njëqind milionë) Lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë të zakonshme me vlerë nominale 100.000.000,00 (njëqind milionë) Lekë, i zotëruar plotësisht nga ortakut i vetëm i Shoqërisë, **AMERICAN CAPITAL Sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS K91616024E, me seli të regjistruar në Rrugën "Jordan Misja," kompleksi "Panorama", kati 1, njësitë nr.10-13, Tiranë, Shqipëri ("Ortakut i Vetëm").

### **Neni 8. | Zmadhimi dhe Zvogëlimi i kapitalit**

- 8.1. Ortakut i Vetëm i Shoqërisë merr vendime për zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë në përputhje me dispozitat e detyrueshme të ligjit shqiptar dhe me dispozitat e këtij Statuti.
- 8.2. Kapitali do të zmadhohet me kontribute në para apo në natyrë, si edhe duke përfshirë rezervat apo fitimet e pashpërndara të Shoqërisë.

### **Neni 9. | Të drejtat dhe Detyrimet e Ortakut të Vetëm**

- 9.1. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë zotërohet tërësisht nga Ortakut i Vetëm i Shoqërisë.
- 9.2. Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë përbëhet nga Ortakut i Vetëm i Shoqërisë, i cili ka të drejtën e një vote në Asamblenë e Përgjithshme, e cila përfaqëson 100% e kapitalit të regjistruar dhe që i jep të drejtën Ortakut të Vetëm të zgjedhi dhe të zgjidhet në organet qeverisëse vendimmarrëse të Shoqërisë, të marri pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë (sipas dispozitave të këtij Statuti dhe atyre ligjore) si edhe të gjithë të drejtat e tjera që parashikohen në këtë Statut.
- 9.3. Ortakut të Vetëm të Shoqërisë do t'i jepet nga menaxhmenti i Shoqërisë, në çdo kohë, pa kërkesë me shkrim, i gjithë informacioni dhe të dhëna lidhur me aktivitetin e Shoqërisë, përfshirë të drejtën e kontrollit të librave dhe të dokumenteve të Shoqërisë.
- 9.4. Detyrimet e Shoqërisë garantohen nëpërmjet kapitalit të saj dhe Ortakut i Vetëm mbajnë përgjegjësi vetëm deri në vlerën e pjesëmarrjes së tij në kapitalin e Shoqërisë; Ortakut i Vetëm nuk mban përgjegjësi përtej vlerës së pjesëmarrjes së tij në kapitalin e Shoqërisë (më përjashtim të rastit të dorëzimit të personale për garantimin e huave apo të detyrimeve të tjera të Shoqërisë).
- 9.5. Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borxhet apo detyrimet personale të Ortakut të Vetëm.

## KAPITULLI IV: Asambleja e Përgjithshme

### Neni 10. | Kompetencat dhe Vendimet e Ortakut të Vetëm

- 10.1. Asambleja e Përgjithshme, e cila përbëhet nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, është organi më i lartë vendimmarrës dhe i kontrollit të Shoqërisë e cila merr vendime në lidhje me aktivitetin e saj dhe politikat ekonomike dhe tregtare të saj.
- 10.2. Asambleja e Përgjithshme ka kompetencat e mëposhtme:
- (a) Miratimi i strukturës organizative të Shoqërisë;
  - (b) Miratimi i emërimit dhe i shkarkimit në çdo kohë të Administratorit(ve) të Shoqërisë;
  - (c) Miratimi i ndryshimit të Statutit apo i formës ligjore të Shoqërisë; apo
  - (d) Miratimi i çdo vendimi tjetër për çështje të tjera lidhur me Shoqërinë përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Statut.

### Neni 11. | Kompetencat Ekskluzive të Ortakut të Vetëm

- 11.1. Kompetencat e mëposhtme i përkasin ekskluzivisht Ortakut të Vetëm dhe nuk mund të delegohen tek Administratori.
- (a) Miratimi i ndryshimit dhe/apo amendimit të Statutit;
  - (b) Miratimi i riorganizimit të Shoqërisë dhe prishjes apo likuidimit të saj;
  - (c) Miratimi i udhëzimeve bazike për kryerjen e aktivitetit tregtar të Shoqërisë;
  - (d) Miratimi i zmadhimit dhe/apo zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë;
  - (e) Miratimi i raporteve vjetore, bilancit, pasqyrave të fitimeve dhe humbjeve, raporteve të auditimit, bilancit dhe likuiditeteve si edhe çdo formë tjetër të pasqyrave financiare të Shoqërisë;
  - (f) Miratimi i mbulimit të humbjeve;
  - (g) Miratimi i rezervës ligjore apo vullnetare të Shoqërisë;
  - (h) Miratimi i themelimit të degëve, filialeve dhe të selive sekondare të Shoqërisë dhe i pjesëmarrjes në shoqëri të tjera, apo interesa të tjera;
  - (i) Miratimi i çdo huaje që Shoqëria merr apo jep përveç kredisë normale tregtare të zbatueshme në fushën e veprimtarisë së Shoqërisë;
  - (j) Miratimi i shpërblimit dhe/apo kompensimit të Administratorit;
  - (k) Miratimi i kryerjes së aktiviteteve të tjera të reja tregtare dhe/apo transaksioneve të reja;
  - (l) Miratimi i krijimit të një hipoteke, pengu apo i garancive të ngjashme;
  - (m) Miratimi i blerjes së pasurive të paluajtshme;
  - (n) Miratimi i blerjes të pjesëmarrjeve apo kuotave të kapitalit të një subjekti tjetër.

## KAPITULLI V: Administratori

### Neni 12. | Administratori(ët)

- 12.1. Shoqëria përfaqësohet dhe menaxhohet nga 1 (një) Administrator i cili është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët dhe është përgjegjës për aktivitetin e zakonshëm tregtar të Shoqërisë me përjashtim të atyre çështjeve që parashikohen në këtë Statut dhe nga ligji i zbatueshëm.
- 12.2. Administratori i Shoqërisë është si vijon:
- **Z. Maksim Caslli**, shtetas shqiptar, i lindur më 03 korrik 1967 në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal G70703114C, i cili ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë ("**Administratori**").
- 12.3. Administratori emërohet në detyrë për një afat prej 3 (tri) vitesh nga data e regjistrimit të Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Shqipëri ("**QKB**") dhe ka të drejtë ripërtëritje.
- 12.4. Administratori emërohet nga Ortaku i Vetëm. Me miratimin e emërimit të tij, Administratori njeh se marrëdhënia e tij me Shoqërinë është një marrëdhënie strikte besimi. Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ka kompetencë që të shkarkojë Administratorin nga detyra e tij në çdo kohë dhe për çfarëdolloj shkak që e mendon të arsyeshme.
- 12.5. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratorit përfshijnë:
- a) T'i propozojnë Ortakut të Vetëm për miratim çdo vendim lidhur me çështjet në kompetencë të Ortakut të Vetëm;
  - b) Të menaxhojnë aktivitetin e përditshëm të Shoqërisë duke zbatuar politikat dhe planet e vendosura nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë;
  - c) Të përfaqësojnë Shoqërinë përkundrejt palëve të treta;
  - d) Të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
  - e) Të përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor dhe bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me propozimet për t'ia paraqitur Ortakut të Vetëm për shpërndarjen e fitimeve;
  - f) Të krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen dhe ekzistencën e Shoqërisë;
  - g) Të kryejnë regjistrimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, pranë QKB-së siç do të kërkohet;
  - h) Të raportojnë përpara Ortakëve për zbatimin e politikave tregtare dhe kryerjen e transaksioneve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
  - i) Të kryejnë detyra të tjera sipas udhëzimeve të Ortakut të Vetëm apo të përcaktuara në ligj, herë pas here.



- 12.6. Administratori do të përfaqësojë Shoqërinë përpara palëve të treta, do të mbikqyri dhe do të sigurohet se punëmarrësit, agjentët, punonjësit, auditorët dhe këshilltarët e Shoqërisë do të tregojnë kujdesin e duhur dhe në interesat më të mira të Shoqërisë.
- 12.7. Përveç detyrave të përgjithshme dhe atribuara sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" ("Ligji Tregtar"), Administratori duhet:
- a) të kryejë detyrat e tyre në përputhje me Ligjin Tregtar, çdo ligji të zbatueshëm apo këtë Statut, me mirëbesim maksimal në interesat më të mira të Shoqërisë në tërësi e që përfshin qëndrueshmërinë mjedisore të aktiviteteve të saj;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i jepen atij sipas ligjit apo këtij Statuti vetëm për qëllimet e caktuara aty;
  - c) të vlerësojë siç duhet të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me Shoqërinë dhe të marri çdo vendim të nevojshëm;
  - d) të shmangi konfliktet e mundshme ndërmjet interesave të tij personale dhe atyre të Shoqërisë;
  - e) të tregojë kujdes dhe të përdori aftësitë në mënyrë të arsyeshme në ushtrimin e detyrave të tij.
- 12.8. Sipas udhëzimeve dhe vendimeve me shkrim të Ortakut të Vetëm, Administratori mund të autorizojë individëve të tretë për të vepruar për llogari të tij dhe për të përfaqësuar Shoqërinë tek të tretët për çështje specifike për zgjidhje sipas vendimit të Ortakut të Vetëm.
- 12.9. Administratori mund të caktojë një përfaqësues dhe t'i japi këtij përfaqësuesi çdo prokurë/autorizim të përgjithshëm për të kryer çdo dhe të gjithë veprimtaritë për administrimin e Shoqërisë, pasi të kenë marrë një autorizim paraprak me shkrim nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
- 12.10 Administratori do të veprojë pa kufizime për transaksionet e kryera nga Shoqëria.

## **KAPITULLI VI: Administrimi Financiar dhe Kontabël i Shoqërisë**

### **Neni 13. | Eksperti Kontabël**

- 13.1. Ortaku i Vetëm do të caktojë një ekspert kontabël të pavarur për auditimin e Shoqërisë në përputhje me ligjin shqiptar.

### **Neni 14. | Viti Financiar**

- 14.1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik. Viti i parë financiar fillon në datën e themelimit të Shoqërisë.

## **Neni 15. | Librat Kontabël**

15.1. Shoqëria do të mbajë kontabilitetin në monedhën shqiptare (Lek) dhe do të përgatisë bilancin dhe pasqyrën e fitim-humbjeve sipas ligjit shqiptar.

## **Neni 16. | Shpërndarja e Fitimeve**

16.1. Fitimi i Shoqërisë përcaktohet në bazë të bilancit të saj të miratuar nga Ortaku i Vetëm. Shpërndarja e fitimeve miratohet nga Ortaku i Vetëm.

16.2. Shoqëria do të krijojë fondin rezervë nga fitimet e saj vjetore sipas dispozitave ligjore të detyrueshme të ligjit shqiptar për rezervën ligjore të detyrueshme.

## **KAPITULLI VII: Të ndryshme**

### **Neni 17. | Gjuha**

17.1. Ky Statut hartohet në 4 (katër) kopje identike në shqip.

### **Neni 18. | Dispozitat Përfundimtare**

18.1. Çështjet që nuk rregullohen shprehimisht në këtë Statut do të rregullohen sipas Ligjit Tregtar.

## **PËR ORTAKUN E VETËM**

### **AMERICAN CAPITAL Sh.p.k.**

përfaqësuar nga  
*Maksim Casli*  
NIPT : K 91616024  
"Dëshmorët e 4 Shkurtit" Nderesë, 14100  
Tirana, Shqipëri  
**MAKSIM CASLI**  
Administrator

